

## 4. PËRMIRËSIME RREGULLATIVE DHE PROCESI I LICENCIMIT

### 4.1 KUADRI RREGULLATIV

Gjatë vitit 2016, procesi i hartimit dhe rishikimit të kuadrit rregullativ mbikëqyrës synoi plotësimin dhe përmirësimin në vazhdimësi të tij nga autoriteti mbikëqyrës, me qëllim sigurimin e përputhshmërisë me kërkesat e ligjit për bankat dhe për afrimin me direktivat dhe rregulloret e Bashkimit Evropian (BE), standardet e Komitetit të Bazelit për një mbikëqyrje bankare efektive, praktikat më të mira në këtë fushë, e njëkohësisht duke konsideruar edhe zhvillimet dhe problematikat e sistemit bankar.


Hartimi dhe rishikimi i rregulloreve të mbikëqyrjes vijoi të realizohet nëpërmjet grupeve të punës, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Departamentit të Mbikëqyrjes, në bashkëpunim me departamentet e tjera të Bankës së Shqipërisë. Pjesë e procesit të hartimit dhe rishikimit të akteve nënligjore kanë qenë edhe bankat dhe subjektet e tjera financiare të licencuara dhe të mbikëqyrura nga Banka e Shqipërisë, të cilët në çdo rast kanë kontribuar me mendimet dhe opinionet e tyre rreth ndryshimeve rregullative.

Gjatë vitit 2016, u finalizua hartimi i disa akteve të reja rregullative me rëndësi për mbikëqyrjen bankare dhe për subjektet e këtyre akteve, si dhe disa rregullore të tjera pësuan ndryshime, si më poshtë vijon:

- Një ndryshim u realizua në rregulloren "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë" (miratuar me vendimin nr. 15, datë 03.02.2016 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë).

Qëllimi i këtij ndryshimi ishte siguri i përputhshmërisë dhe konsistencës me konceptet e përdorura për vlerësimin e gjendjes financiare të bankës edhe në dokumente të tjera në fuqi, të tilla si dokumenti "Politika e Mbikëqyrjes" dhe "Manuali i Vlerësimit të Rreziqeve".

- Disa ndryshime u realizuan në rregulloren "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka" (miratuar me vendimin nr. 47, datë 30.03.2016, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë).
- Disa ndryshime u realizuan në rregulloren "Për licencimin, organizimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e zyrave të këmbimit valutor" (miratuar me vendimin nr. 48, datë 30.03.2016, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë).



Rishikimi i njëkohshëm i rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka” dhe rregullores “Për licencimin, organizimin, veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e zyrave të këmbimit valutor”, u krye në funksion të adresimit të disa çështjeve të evidentuara nga praktikat e licencimit, lidhur me trajtimin e agjentëve të subjekteve financiare jobanka për shërbimet e pagesave. Qëllimi i këtyre ndryshimeve rregulative ishte sigurimi i një qasjeje mbikëqyrëse më efektive ndaj subjekteve financiare jobanka dhe institucioneve të parasë elektronike, nëpërmjet rritjes së rolit dhe përgjegjësisë së vetë këtyre subjekteve në sigurimin e plotësueshmërisë së kriterëve kualifikuese për agjentët e tyre, në përputhje edhe me kërkesat e direktivave të BE-së në fushën e pagesave, duke shfuqizuar si rrjedhojë procesin e miratimit të agjentëve nga autoriteti mbikëqyrës për subjektet e sipërcituara. Njëkohësisht, në kuadër të zbatimit të planit të masave për reduktimin e kredive me probleme, në rregulloren “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka”, u përcaktuan kërkesa lehtësuese për nivelin e kapitalit minimal të kërkuar të subjekteve që blejnë kredi me probleme.

- Disa ndryshime u realizuan në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit” (miratuar me vendimin nr. 49, datë 30.03.2016, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë).
- Disa ndryshime u realizuan në rregulloren “Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja” (miratuar me vendimin nr. 50, datë 30.03.2016, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë).

Rishikimi i njëkohshëm i të dyja rregulloreve të sipërpërmendura, u realizua në përmbushje të angazhimeve të Bankës së Shqipërisë, të ndërrmarra në kuadër të planit ndërinstitucional të masave “Për reduktimin e kredive të këqija në sistemin bankar”. Ndryshimet synuan adresimin e shqetësimit mbi akumulimin në bilancet e bankave gjatë viteve të fundit, të tepricës së mjeteve të përfutura nga shlyerja e kredive. Ndryshimet konsistuan në saktësimin e procesit të fshirjes së kredive nga bilanci i bankave nëpërmjet regjistrimit dhe mbajtjes së tyre jashtë bilancit; provigjionimin e plotë të mjeteve të qëndrueshme të marra nga procesi i ekzekutimeve për një periudhë maksimale deri në shtatë vjet dhe aplikimin e një peshe më të lartë rreziku për këto aktive.

- Miratimi i rregullores së re “Për kërkesat minimale të sigurisë në ambientet ku kryhen veprimtaritë bankare dhe financiare dhe për transportin e vlerave monetare” (miratuar me vendimin nr. 67, datë 01.06.2016, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë).

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave minimale për sigurinë në ambientet në të cilat ushtrohen veprimtaritë bankare dhe/ose financiare, si dhe për transportin e vlerave monetare me qëllim zhvillimin normal dhe në mënyrë të sigurt të këtyre veprimtarive. Rishikimi tërësor i rregullores ekzistuese në bashkëpunim me Departamentin e Sigurimit dhe Mbrojtjes mori në konsideratë dhe synoi të japë zgjidhje për problematikat e ndryshme, të hasura nga inspektimet e kryera në degët dhe agjencitë e bankave, në subjektet financiare jobanka si dhe në zyrat e këmbimit valutor.



- Miratimi i rregullores së re “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre” (miratuar me vendimin nr. 104, datë 05.10.2016, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë).

Rishikimi tërësor i rregullores ekzistuese, erdhi si kërkesë e përputhshmërisë me ligjin e ri nr. 52/2016, datë 19.05.2016 “Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre” dhe e plotësimit të kuadrit ligjor me aktet nënligjore përkatëse. Rishikimi konsistoi më konkretisht në përcaktimin e veprimtarive të lejuara për t’u kryer nga shoqëritë e kursim-kreditit (SHKK)<sup>3</sup> si dhe të kërkesave përkatëse për kapital sipas llojit të veprimtarive financiare që do të kryejnë; kërkesave dhe dokumentacionit të nevojshëm për licencimin e SHKK-ve dhe të unioneve të tyre; kritereve që duhet të plotësojnë anëtarët e organeve drejtuese të këtyre subjekteve; dokumentacionit të nevojshëm për veprimtaritë shtesë apo emërimet e anëtarëve të organeve drejtuese që kërkojnë miratim nga Banka e Shqipërisë; kërkesave dhe dokumentacionit të nevojshëm për realizimin e procedurave për riorganizimin juridik të shoqërive të kursim-kreditit në format e bashkimit me përthithje, bashkimit me krijim, ndarjes me përthithje dhe ndarjes me krijim, të cilat nuk parashikoheshin më parë në kuadrin rregullativ përkatës; kushteve kualifikuese dhe skualifikuese për likuidatorin; disa kërkesave për rastet e përfundimit të anëtarësisë së SHKK-së në union; etj.

- Miratimi i rregullores së re “Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre” (miratuar me vendimin nr. 105, datë 05.10.2016, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë).

Rishikimi tërësor i rregullores ekzistuese “Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre” parashikon kërkesa të reja për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e këtyre subjekteve duke prezantuar edhe parime dhe rregulla bazë të drejtimit të përgjegjshëm dhe efektiv (*corporate governance*), norma të reja për administrimin e rreziqeve, rregulla për transparencën e SHKK-ve me anëtarët për produktet dhe shërbimet që ofrojnë, si dhe kërkesa raportuese dhe masa më të përforcuara mbikëqyrëse.

Më konkretisht, rishikimi konsistoi në përcaktimin e: parimeve dhe rregullave bazë të drejtimit të përgjegjshëm dhe efektiv, duke përfshirë disa kërkesa për organet drejtuese dhe kulturën e përgjithshme të drejtimit, sistemin e administrimit të rrezikut, njësinë e kontrollit të brendshëm dhe politikat e shpërblimit të SHKK-ve dhe unioneve të tyre; treguesve të ndryshëm lidhur me administrimin e rreziqeve, duke përfshirë normat e lejuara për treguesit e mjaftueshmërisë së kapitalit, kufijtë maksimalë të lejueshëm të ekspozimit të madh, normat e lejueshme për pozicionet e hapura valutore; rregullave për administrimin e rrezikut të kredisë, klasifikimin e kredive sipas pesë klasave (nga katër klasa që parashikoheshin në rregulloren e mëparshme) dhe përcaktimin e normave përkatëse të fondeve

<sup>3</sup> Krahas veprimtarive bazë të pranimit të depozitave dhe dhënies së kredive për anëtarët, tashmë SHKK-të lejohen të ushtrojnë edhe veprimtaritë financiare të shërbimeve të pagesave dhe të transferimit të parave, të këmbimit valutor dhe të qirasë financiare.



rezervë për mbulimin e humbjeve sipas klasave, përcaktimin e kriterëve për ristrukturimin e kredive dhe fshirjen e kredive të humbura nga bilanci; rregullave për administrimin e rrezikut të qirasë financiare si një veprimtari e re që i lejohet tashmë SHKK-ve, sipas dispozitave të reja rregullative të Bankës së Shqipërisë, duke përcaktuar njëkohësisht edhe klasifikimin e kontratave të qirasë financiare sipas klasave dhe përcaktimin e normave të fondeve rezervë përkatëse; rregullave për administrimin e rreziqeve të tjera si: rreziku i likuiditetit nëpërmjet përcaktimit të kufijve përkatës, rreziku operacional, çështje të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, parandalimi i pastrimit të parave; kërkesave të përgjithshme mbi transparencën e SHKK-së ndaj anëtarëve për sa i përket produkteve dhe shërbimeve që ajo ofron, duke specifikuar kërkesat lidhur me elementët e kontratës së kredisë, elementët e kontratës së depozitës, mënyrës se si do trajtohen ankesat e kredimarrësve, si dhe të drejtat dhe detyrimet në rastin e shlyerjes (pagesës) së kredisë para afatit të maturimit, etj.

- Miratimi i "Sistemit raportues për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre" (miratuar me vendimin nr. 106, datë 05.10.2016, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë).

Qëllimi i rishikimit tërësor të sistemit raportues për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre është hartimi i një pakete të plotë me formularë të rinj, duke përmbledhur formularët për raportimin e të dhënave nga unioni, të dhënave të agreguara të të gjitha SHKK-ve anëtare në union, si dhe të dhënave të çdo SHKK-je individuale. Formularët e sistemit të ri raportues synojnë të përshtasin kërkesat e reja ligjore dhe rregullative, të sigurojnë më tepër informacion për mbikëqyrjen nga jashtë, por edhe më tepër të dhëna me natyrë statistikore. Formularët e rinj u shoqëruan gjithashtu edhe nga një udhëzues për plotësimin e tyre nga SHKK-të dhe nga unionet.



## HAPËSIRË INFORMUESE 2. KUADRI LIGJOR E RREGULLATIV PËR LICENCIMIN, MBIKËQYRJEN, ADMINISTRIMIN E RREZIKUT DHE RAPORTIMIN E SHOQËRIVE TË KURSIM-KREDITIT (SHKK-VE) DHE UNIONEVE TË TYRE

Gjatë vitit 2016, Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me Bankën Botërore dhe me palët e interesit, hartoi Ligjin "Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre", i cili u miratua nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në muajin maj 2016. Hartimi i këtij ligji u diktua nga dinamika e zhvillimit dhe problematika e ndeshur gjatë zbatimit të ligjit të mëparshëm. Synimi kryesor i hartimit të këtij ligji ishte konsolidimi i tregut të shoqërive të kursim-kreditit dhe forcimi i mbikëqyrjes së këtij sektori në kushtet kur këto subjekte kanë tashmë detyrimin për t'u përfshirë edhe në skemën e sigurimit të depozitave. Ligji në fjalë ka si qëllim përcaktimin e kushteve dhe rregullave për krijimin, licencimin, organizimin, drejtimin, kujdestarinë dhe likuidimin e SHKK-ve dhe unioneve të tyre, si dhe mbikëqyrjen e tyre në Republikën e Shqipërisë.

Hyrja në fuqi e këtij ligji, solli ndryshime të dukshme në numrin dhe madhësinë, si dhe në ristrukturimin e organizimit dhe veprimtarisë së këtyre subjekteve.

Në mbështetje dhe në funksion të zbatimit të Ligjit "Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre", Banka e Shqipërisë rishikoi tërësisht kuadrin rregullativ në fuqi për mbikëqyrjen e këtyre subjekteve dhe më konkretisht rregulloren për procesin e licencimit, administrimit të rrezikut dhe sistemin raportues të tyre.

Në referencë të dispozitave të ligjit për SHKK-të dhe sipas dispozitave tranzitore të parashikuara në kuadrin rregullativ përkatës, SHKK-ve dhe unioneve të licencuara nga Banka e Shqipërisë, të cilat ushtrojnë veprimtari përpara hyrjes në fuqi të këtyre akteve të reja rregullative, iu është lejuar koha e nevojshme, respektivisht:

- a) për të marrë masa për organizimin e veprimtarisë dhe strukturës së brendshme deri në 30 qershor 2017;
- b) për të marrë masat për t'u përshtatur me formatin e ri të sistemit raportues, deri në 30 qershor 2017;
- c) për plotësimin e niveleve minimale të kapitalit dhe të raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit, deri në 30 qershor 2018;
- d) për të marrë masa për përshtatjen e sistemeve të brendshme për kontabilizimin e interesave sipas metodës së përlllogaritur, deri në 30 qershor 2021.

Për t'iu përshtatur zhvillimeve në subjektet e SHKK-ve si rrjedhojë e miratimit të ligjit të ri u rishikua i gjithë kuadri rregullativ që rregullon veprimtarinë e këtyre subjekteve ku përmenden rregullorja "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre", rregullorja "Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre" dhe "Sistemi Raportues për Shoqëritë e Kursim-Kreditit dhe Unionet e tyre".



- Disa shtesa dhe ndryshime u realizuan edhe në rregulloren “Për kërkesat minimale të sigurisë në ambientet ku kryhen veprimtaritë bankare dhe financiare dhe për transportin e vlerave monetare” (miratuar me vendimin nr. 107, datë 05.10.2016, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë).

Ky rishikim erdhi në zbatim të kërkesave të parashikuara në rregulloren “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së shoqërive të kursim-kreditit dhe unioneve të tyre”, për kryerjen e veprimtarive financiare shtesë, duke përfshirë edhe SHKK-të dhe unionet, si subjekte të plotësueshmërisë së kërkesave të kësaj rregulloreje në lidhje me kushtet teknike dhe të sigurisë, në rastin kur këto veprimtari kryhen me sportel.

- Disa ndryshime u realizuan në rregulloren “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka” (miratuar me vendimin nr. 121, datë 09.11.2016, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë).
- Disa ndryshime u realizuan në rregulloren “Për instrumentet e pagesave elektronike” (miratuar me vendimin nr. 122, datë 09.11.2016, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë).


Rishikimi i njëkohshëm i këtyre dy rregulloreve, u realizua në kuadër të përafrimit dhe në përputhje me dispozitat e direktivave të BE-së për shërbimet e pagesave në tregun e brendshëm dhe për institucionet e parasë elektronike, si dhe duke marrë në konsideratë zhvillimin dhe konsolidimin në vazhdimësi të këtyre institucioneve në tregun financiar shqiptar, në një kohë kur kërkesat e tregut janë në rritje për përfitim të një game dhe shumëllojshmërie të produkteve dhe shërbimeve financiare.

Ndryshimet parashikuan disa përjashtime nga kërkesat licencuese për subjektet apo personat që ofrojnë shërbimet e pagesave nëpërmjet telefonisë celulare ose pajisjeve të tjera elektronike, vetëm për blerjen e biletave elektronike, si dhe rritjen e niveleve të kapitalit fillestar minimal, të kërkuar për institucionet e parasë elektronike. Njëkohësisht, për instrumentet e pagesave elektronike u reflektua në rregulloren përkatëse edhe heqja e kufijve maksimalë të emetimit të parasë elektronike, si për instrumentet pa rimbushje, ashtu edhe për ato me rimbushje, duke e lënë në vullnetin e palëve përcaktimin e kufirit minimal dhe maksimal, në kontratën që hartojnë midis tyre, por duke u shoqëruar me kërkesa shtesë për rritjen e niveleve të kapitalit fillestar minimal të kërkuar për institucionet e parasë elektronike, nga 20 milionë në 50 milionë lekë.



## 4.2 LICENCIMI

Struktura e sistemit bankar dhe financiar në fund të vitit 2016 përbëhet nga 16 banka, 28 subjekte financiare jobanka, 428 zyra të këmbimit valutor, 13 shoqëri të kursim-kreditit dhe 2 unione të shoqërive të kursim-kreditit.




Banka e Shqipërisë bazuar në ligjin për bankat në Republikën e Shqipërisë ka autoritetin të licencojë dhe të mbikëqyrë bankat, subjektet financiare jobanka, shoqëritë e kursim-kreditit e unionet e tyre, zyrat e këmbimit valutor dhe zyrat e përfaqësimit të bankave të huaja. Gjatë vitit 2016, në kuadër të përmbushjes së funksionit licencues, Banka e Shqipërisë ka marrë vendime që lidhen me:

- licencimin e katër subjekteve financiare jobanka, respektivisht për ushtrimin e veprimtarisë financiare të kredithënies, të faktoringut dhe të qirasë financiare (Albanian Financial Institution sh.p.k.), për ushtrimin e veprimtarisë financiare të kredithënies (Micro Credit Albania sh.a.) dhe për ushtrimin e veprimtarisë financiare të shërbimeve të pagesave dhe transferimit të parave (Kastrati sh.p.k., Pay and Go sh.p.k.);
- revokimin e tre licencave të subjekteve financiare jobanka, përkatësisht të subjektit financiar jobankë Tirana Leasing sh.a., për arsye të likuidimit vullnetar të shoqërisë, të subjektit financiar jobankë Credins Leasing sh.a., për arsye të riorganizimit të Bankës Credins sh.a. nëpërmjet bashkimit me përthithje me subjektin financiar jobankë, të institucionit financiar të mikrokredisë Micro Credit Albania sh.a., për shkak të shndërrimit të tij në subjekt financiar jobankë;




- miratimin paraprak për kryerjen e veprimtarive financiare shpesh nga bankat dhe subjektet financiare jobanka. Konkretisht, Banka e Shqipërisë dhe miratimin për shtimin e veprimtarive financiare në aneksin e licencave të Bankës Ndërkombëtare Tregtare sh.a., të Bankës Societe Generale Albania sh.a., të Bankës Amerikane të Investimeve sh.a., të subjektit financiar jobankë Tranzit sh.p.k., të subjektit financiar jobankë NOA sh.a. dhe të subjektit financiar jobankë Albanian Financial Institution sh.p.k. Veprimtaritë shpesh konsistojnë në veprimtaritë financiare të ofrimit të garancive dhe marrjes së angazhimeve, të tregimit të letrave me vlerë të transferueshme, të ndërmjetësimit në sigurime, të faktoringut, të ndërmjetësimit për transaksionet monetare për administrimin e aktiveve, të marrjes në kujdestari, të shërbimeve depozituese dhe të besimit, të qirasë financiare etj., të parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi. Gjatë vitit 2016, Banka Raiffeisen shtoi një kanal të ri komunikimi për shërbimet e-banking, nëpërmjet platformës Digital Banking dhe Banka Credins, në cilësinë e lëshuesit të kartave, shtoi në listën e instrumenteve të pagesave elektronike edhe kartat elektronike Master Card;
- miratimin paraprak për emetimin e borxhit të varur nga 1 bankë si dhe miratimin e ndryshimeve në statutin e 4 bankave të sistemit;
- miratimin paraprak për transferimin e pjesëmarrjes influencuese (të tërthortë) në kapitalin aksioner të Veneto Banka sh.a., miratimin paraprak për transferimin e kuotave të kapitalit (kontrollit) të subjekteve financiare jobanka Platinum Investment sh.p.k. dhe Agro & Social Fund sh.p.k. (ish-VisionFund Albania sh.p.k.);
- miratimin e 48 administratorëve të bankave dhe subjekteve financiare jobanka, nga të cilët 13 janë anëtarë të këshillave drejtues, 7 janë anëtarë të komiteteve të kontrollit dhe 28 janë drejtorë të përgjithshëm dhe drejtues ekzekutivë;
- miratimin paraprak për zgjerimin e rrjetit të bankave.

Grafik 2 Ecuria e numrit të degëve/agjencive të bankave në vite




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në fund të vitit 2016, bankat e ushtrijnë veprimtarinë nëpërmjet 493 degëve/agjencive të shtrira brenda territorit të vendit, ndërkohë që vetëm një bankë vijon të ketë një degë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.






Shpërndarja gjeografike e degëve/agjencive bankare përshin pothuajse të gjithë territorin e vendit, ndërkohë që vazhdon të evidentohet një përqendrim më i madh i degëve dhe agjencive bankare në Tiranë (42%) ku edhe përqendrimi i popullsisë është më i madh (29%). Po kështu, evidentohet që shpërndarja e degëve dhe agjencive bankare sipas rajoneve është në përpjesëtim të drejtë me numrin e popullsisë.



Viti 2016 u shoqërua me një ritëm pozitiv në shtimin e kërkesave të subjekteve për ushtrimin e veprimtarisë financiare të këmbimit valutor. Në fund të këtij viti, numri i zyrave të këmbimit valutor arriti në 428 ose 31 zyra këmbimi valutor më shumë se vitin e kaluar. Gjatë vitit u dhanë 39 licenca të reja, si dhe u revokuan me kërkesë të vetë subjekteve 8 licenca për veprimtaritë e këmbimit valutor.

Gjithashtu, miratime u dhanë edhe për zgjerimin e veprimtarisë së zyrave të këmbimit valutor të licencuara nëpërmjet hapjes së zyrave të reja dhe punësimit të kambistëve të rinj.

Zyrat e këmbimit valutor janë të lokalizuara dhe ushtrojnë veprimtarinë në qytetet kryesore të vendit, si dhe evidentohet përqendrimi më i madh i tyre në



qytetin e Tiranës. Zgjerimi i shtrirjes gjeografike të subjekteve të licencuara për zyra të këmbimit valutor, përfshiu 14 qytete të vendit, ku vetëm qyteti i Tiranës vazhdon të dominojë me 41% të totalit të rritjes, si dhe qyteti i Fierit me 10% të rritjes së numrit të zyrave të këmbimit valutor.

*Në zbatim të kërkesave të kuadrit rregullativ në fuqi, subjektet financiare jobanka dhe institucionet e parasë elektronike mund të ushtrojnë veprimtarinë e shërbimeve të pagesave dhe të transferimit të parave dhe/ose të shpërndarjes dhe ripagimit të fondeve, në rastin e institucioneve të parasë elektronike, edhe nëpërmjet agjentëve. Në fund të vitit 2016, numri i agjentëve të këtyre subjekteve është 1,169.*

Tabelë 2. Numri i agjentëve për transferimin e parave deri në fund të vitit 2016

	AK-INVEST	UNIONI FINANCIAR TIRANË	VODAFONE MPESA	EASYPAY	TOTALI
Agjentë që kryejnë veprimtarinë e transferimit të parave në emër të subjektit financiar jobankë	326	273			599
Agjentë të institucionit të parasë elektronike			342	228	570
<b>TOTALI</b>	<b>326</b>	<b>273</b>	<b>342</b>	<b>228</b>	<b>1,169</b>

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në kategorinë e shoqërive të kursim-kreditit, gjatë vitit 2016 nuk pati licencime të reja, ndërkohë që u finalizua procesi i riorganizimit të shoqërive të kursim-kreditit, nëpërmjet bashkimit me përthithje të 98 shoqërive të kursim-kreditit mbi bazën e shoqërive të kursim-kreditit ekzistuese. Kështu, në fund të vitit 2016 numërohen 13 shoqëri të kursim-kreditit dhe 2 unione të shoqërive të kursim-kreditit.

Gjatë vitit 2016, ndryshimet strukturore në pronësinë e bankave dhe të subjekteve financiare jobanka, konsistojnë kryesisht në ndryshime të pjesëmarrjeve joinfluencuese në zotërimin e aksioneve apo të kuotave të kapitalit të tyre, ndërkohë që evidentohen edhe rritje të kapitalit aksioner të këtyre subjekteve.

